

Mësimi 4: Planifikimi i Shërbimit dhe Aktiviteteve

Ju mund ta zhvilloni të gjithë mësimin ose ta ndani atë në segmente më të shkurtra. Përshtateni mësimin me rrethanat tuaja vendore dhe nevojat, moshën dhe kuptueshmërinë e presidencës së kuorumit ose klasës suaj.

SHËRBIMI DHE AKTIVITETET MUND TË NA NDIHMOJNË QË TË NDJEKIM SHPËTIMTARIN

Në rininë e Tij, Jezu Krishti "rritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve" (Lluka 2:52).

Kërkojuni anëtarëve të presidencave të kuorumeve dhe të klasave të diskutojnë se përse shërbimi dhe aktivitetet janë të rëndësishme. Si mund të na ndihmojnë ato që të bëhemi më shumë si Shpëtimtari?

NE MUND TA PËRMBUSHIM PUNËN E ZOTIT NËPËRMJET PLANIFIKIMIT ME QËLLIM

Ftojini anëtarët e presidencave t'i shqyrtojnë parimet që renditen tek [Orientime mbi Shërbimin dhe Veprimtaritë për Rininë](#). Vërinë ata të përdorin [Planifikuesin e Shërbimeve dhe Aktiviteteve](#) që t'i ndihmojë të bëjnë një listë të disa ideve për shërbim dhe aktivitete që i ndjekin ato parime. Kërkojuni atyre të planifikojnë një nga ato aktivitete në mënyrë më të hollësishme duke përdorur materialin [Plani i Hollësishëm për Shërbimin dhe Aktivitetin](#). Në një mbledhje të ardhshme të presidencës, kërkojuni atyre të shqyrtojnë aktivitetet që kanë pasur dhe se sa të suksesshme ishin ato, sipas parimeve të materialit [Orientime mbi Shërbimin dhe Veprimtaritë për Rininë](#).

BURIME PËRKRAHËSE

- Ide për shërbim dhe aktivitete te ChildrenandYouth.ChurchofJesusChrist.org
- *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, kapitulli 20, ChurchofJesusChrist.org